



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 29 shtator 2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303-

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Bislimi, Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa dhe Naim Fetahu.

Munguan: Valdete Bajrami dhe Duda Balje.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në Komision, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Xhejlane Hoxha- Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Enis Spahiu- Ministria e Financave, Sanije Berisha- OSBE, Qendresa Mulaj- ZAP, Bujar Bajraktari- ZAP, Besmir Kokollari- Instituti i CHAT, Artan Canhasi- KDI, Carolina Leersch- GIZ, Shefki Kastrati- NDI, Kaltrina Ahmeti- GLPS dhe Florina Merovci- ZPRK.

Mbledhjen e kryesoi: Besnik Bislimi, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014;
4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014;
5. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014;
6. Të ndryshme;

***Kryetari,** pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

***Kryetari** - konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.*

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

***Kryetari** – i njoftojë deputetët si dhe të pranishmit, se kjo pikë e rendit të ditës, është shtyrë nga java e kaluar, me qëllim që të vijë përfaqësuesi i Ministrisë së Financave për ta arsyetuar projektligjin. Me këtë hapi diskutimin.*

Enis Spahiu- theksoi se Ministria e Financave është sponzor i Projektligjit të Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës në kuadër të programit legjislativ për vitin 2015. Me këtë rast, ne jemi munduar ta fuqizojmë Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit. Fuqizimi i kësaj zyreje, është në interes të kontrollit më të mirë të shpenzimit të parasë publike, për procedurat e emërimit dhe vazhdimet të mandatit të auditorit. Vlerësimi i ndikimit financiar, tregon se ky Projektligj ka implikime financiare, mirëpo mjetet për këtë janë të vlerësuara në kuadër të KASH-it për vitet 2016 - 2018. Poashtu edhe nga aspekti i Integritimeve Evropiane, kemi aprovimin se ky Projektligj nuk bie ndesh me parimet e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Kryetari – pyeti se sipas sqarimit të Ministrisë së Financave, thuhet se me Projektligj forcohet roli i pozitës së Auditorit dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit, andaj si mund të bëhet kjo pa implikime financiare?

Enis Spahiu- Kosto financiare do të ketë, mirëpo kjo është e mundur brenda ndarjes buxhetore aktuale.

Ali Sadriu- Unë pajtohem me fuqizimin e rolit të auditorit me këtë Projektligj, poashtu me këtë Projektligj thuhet se rregullohet mënyra më e mirë e përzgjedhjes së auditorit të përgjithshëm, e që me ligjin paraprak ka pasur zbrazëtira në këtë fushë. Me këtë mendojë, se në përzgjedhjen e auditorit duhet të jenë së paku edhe dy anëtarë të KMFP- së si vëzhgues, megjithatë unë e përkrah në parim këtë projektligj.

Adem Grabovci- dha vërejtje sa i përket nenit 4 pika 6, ku thuhet se pozita e auditorit kërkon një person të paanshëm, me moral të lartë, i përgjegjshëm etj. Pyetja ime është, se kush është ai autoritet që do të mund ta vlerëson integritetin dhe moralin e kandidatit? Këtu shtrohet pyetja se cka po kërkohet të zgjidhet në këtë rast?

Hajdar Beqa- po ashtu edhe unë në parim pajtohem që Projektligji të kalon në lexim të parë në komision, pastaj ne si KMFP përmes një grupi punues, t'i shqyrtojmë nenet dhe amandamentet t'i paraqesim në KMFP si dhe në seancë plenare më pastaj.

Kryetari – unë kam vërejtje sa i përket detyrave dhe përgjegjësive të Zyrës Kombëtare të Auditimit, mendoj se nuk janë të definuara qartë me këtë Projektligj. Megjithatë, unë në parim e përkrah këtë Projektligj dhe propozoj një grup punues në përbërje prej Synavere Rysha, Hajdar Beqa, Besnik Bislimi si dhe shoqëria civile të jap imputet e veta në këtë Projektligj. Me këtë e hodhi në votim propozimin për aprovimin në parim të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Perfundim

Aprovohet në parim Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014

Kryetari- theksoi se raporti i auditimit për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore e ka opinionin e pamodifikuar, çka do të thotë se PVF, paraqesin një pamje të drejtë dhe të saktë, në përjashtim të disa vërejtjeve që ka dhënë ZAP- i në këtë raport. Me këtë hapi diskutimin.

Bujar Bajraktari- theksoi se auditimi për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2014, është auditim i rregullsisë dhe gjatë auditimit nuk është vërejtur se ka pasur shkelje. Kemi dhënë dy rekomandime për fusha të vlerësuara jo mirë, poashtu edhe rekomandimet e vitit paraprak ishin zbatuar në përpikëri.

Xhejlane Hoxha- Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i ka vetëm 7 të punësuar, gjatë tri viteve të fundit nuk kemi pasur bord të emëruar nga Kuvendi dhe se përgjegjësia për udhëheqje të këtij institucioni ka qenë mbi mua. Ashtu siç shihet edhe në raportet e auditimit, ne nuk kemi pasur shkelje ligjore dhe as të procedurave. Rekomandimet e dhëna nga ZAP- i, implementimi i tyre nuk varet vetëm nga institucioni, por edhe nga MAP- i.

Synavere Rysha- pyeti sa i përket bazës ligjore për pagesën e punëtorëve për orarin e zgjatur të punës, si dhe a keni pasur të drejt të kërkonte nga të punësuarit të punojnë me orar të zgjatur të

punës? Po ashtu dëshiroj të dijë, se cilat janë pengesat në mos rekrutimin e stafit brenda Këshillit për Trashëgimi Kulturor?

Xhejlane Hoxha- sa i përket bazës ligjore për 40 orë shtesë në muaj, ekziston udhëzimi administrativ i MAP-it, ndërsa të drejtën për të punuar me orar të zgjatur, është në bazë të një vendimi të bordit të vitit 2009. Sa i përket rekrutimit të stafit, ne kemi provuar disa herë me konkurs, mirëpo nuk kemi arritur t'i gjejmë personat kompetent siç kërkohet me kriteret e përcaktuara.

Ali Sadriu- pyeti se arsyetimi që po jep përfaqësuesja nga Këshilli për Trashëgimi Kulturor, dallon në esenc nga ajo që ka paraqitur ZAP- i në raport, dëshirojë një sqarim më konkret për këtë nga përfaqësuesit e ZAP-it?

Ibrahim Gylderren- theksoi se pagesa e shërbyeseve civil rregullohet me Ligj të Pagave si dhe me Ligjin mbi Shërbimin Civil, mirëpo në raport të auditimit nuk ka pasur dilema për këtë, vërejtja është dhënë, se te stafi nuk janë evidentuar të punësuarit në ndonjë evidenc për punët mbi orarin e zgjatur.

Kryetari- unë kam një breng timen, se si një institucion që ka vetëm 7 të punësuar, ka poashtu një bord prej 7 anëtarëve, kjo në fakt më duket e pajustificueshme. Poashtu pritet që Kosova të pranohet në UNESCO dhe të lihet një institucion vetëm me një numër simbolik të punësuarve, duket si jo reale dhe e pajustificueshme, dhe me një buxhet nga viti në vit e më i pakët. Si mendoni me e adresu këtë.

Xhejlane Hoxha- ky bord prej 7 anëtarëve nuk është bord drejtues i institucionit, por është bordi i cili është mandatuar të bëjë shpalljen e pronave të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës nën rritje të shtetit. Me këtë mbylli diskutimin për këtë pike.

Përfundim

Komisioni vendosi që Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, të mos adresohet për seancë plenare.

4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014

Kryetari, konstatoi se në mungesë të përfaqësuesve të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

5. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014

Kryetari, konstatoi se në mungesë të përfaqësuesve të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

6. Të ndryshme

Kryetari- për ata të cilët nuk janë të informuar, komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka pasur një vizitë sudimore në Gjermani, në Bundestagun gjerman, ku kemi pasur takime shumë të rëndësishme, me komisionet parlamentare të Bundestagut, me Auditorin e Përgjithshëm të Gjermanisë, kemi pasur takime edhe me komisinete hetimore të Landit të Berlinit dhe me Senatin e Berlinit, unë kam përgatitur një shkresë falënderimi për GIZ- in, në emër të komisionit, të cilën do ta lexoj.

E nderuara zonja Fehlinger, në emër të gjithë anëtarëve të KMFP, dua të falënderohem për vizitën që projekti juaj ka organizuar në Bundestagun gjerman dhe Administratën e Senatit të Berlinit, ju na keni dhënë mundësinë që të kemi disa takime shumë të rëndësishme me përfaqësues të Bundestagut gjerman, Auditorit të Përgjithshëm, Landit të Berlinit si dhe Kryeprokurorin. Gjithashtu, dëshiroj të ju falënderoj për një organizim shembullor të vizitës, në

mënyrë që i gjithë qëndrimi jonë në Berlin, të na mbetet në kujtesë si një përvojë e jashtëzakonshme, ju falënderoj.

Alexandra Fehlinger- faleminderit shumë secilit që ka qenë pjesë e udhëtimit tonë në Berlin, mendoj që ka qenë i suksesshëm, synimi i kësaj vizite ka qenë që të mundësojmë diskutimin dhe shkëmbimin e përvojave në mes anëtarëve të komisionit dhe partnerëve tonë në Gjermani, për të parë se si mund të arrihet një mbikëqyrje efektive e buxhetit nga ana e parlamentit, gjithnjë duke e ditur se Gjermania e ka një përvojë relativisht të madhe në këtë drejtim, krahasuar me një demokraci të re siç është Kosova, mendoj se ka shumë mësim që mund t'i nxjerrim nga kjo vizitë dhe të shohim se cilat janë punët të cilat janë me rëndësi këtu si komision. Janë dy elemente kryesore të cilat mundem t'i veçoj këtu, mësimi i parë jashtëzakonisht i mirë, është bashkëpunimi në mes institucioneve dhe brenda institucioneve, kështu që në mënyrë efektive të kryhet mandati i secilit institucion, një prej përvojave ka qenë takimi me zonjën Hakedorn, ku kemi kuptuar se 99% e vendimeve të KMFP merren në mënyrë unanime. Tjetër mësim është edhe diskutimi për projektligjin për auditorin, se si auditori gjeneral mundëson kryerjen efektive dhe mbikëqyrjen e punës së institucioneve, çështja e dytë që është shumë me rëndësi është ndarja shumë efektive e punës në mes parlamentarëve që janë në një komision, në mes komisioneve të ndryshme por edhe në mes grupeve parlamentare në secilin komision. Prandaj, do ju ftoj për një puntori që do të mbahet pas dy javësh, me ekspertin nga parlamenti jonë që është për financa, të cilën e kemi ftuar që të kthehet këtu dhe të bisedoj me ne, dhe të japë disa shembuj praktik se si bëhen raportet e auditorit gjeneral, ku do të bëjmë krahasime të raporteve të auditorëve gjeneral.

Kryetari- falënderon zonjën Fehlinger dhe konstaton se me këtë përmbajtje kjo shkresë të shkoj në Bundestag si nikoqir i kësaj vizite, pra tek përfaqësuesit e Komisionit të Mbikëqyrjes së Financave Publike në Bundestag si dhe në Komision të Financave të Bundestagut. Me këtë mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi